
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	05.06.2020
Për/ Za/ To:	“Rexha SHPK”
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 02.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Rexha SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Tregu i ri i qytetit”, me Numër të Prokurimit: **616 19 9686 511** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga “Rexha SHPK” e dates 02.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Tregu i ri i qytetit”, me Nr. të Prok: **616 19 9686 511**, kundër Vendimit të AK –së, të datës **28.05.2020**.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull “Tregu i ri i qytetit”, me Nr. të Prok: **616 19 9686 511** sipas njoftimit të dates **28.05.2020**.
3. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 03,04 dhe 05 .06.2020 ka shqyrtuar kërkesën e grupit të OE-ik “Rexha SHPK&” dhe lidhur me pretendimet e të njejtit ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi i parë është pjesërisht i bazuar pasi që duke analizuar dëshmitë tuja të dorëzuara nga ATK-ja për vitet 2016,2017 dhe 2018 dhe raportin bankar për vitin 2019 konstatoj se ka ekzistuar mundësia ligjore që të kërkohen sqarime shtesë,por kjo nuk është bere per arsye se ju nuk keni plotësuar kriterin per referencat per pune te kerkuara ne FDT e qe do ta sqarojme ne piken vijuese;

-Pretendimi tjetër se Autoriteti Kontraktues ka sqaruar në fazën para hapjes së tenderit se nuk janë të pranueshme referencat për renovime,por vetëm për ndërtimet e reja është i formuluar si duhet,pasi që e verteta është se formulimi ynë ka qenë i tillë dhe në bazë të të njejtit janë trajtuar referencat e të gjithë tenderuesëve e edhe tuajat.Këtu duhet shtuar se po në atë fazë një tenderues ka dorëzuar kerkesë për rishqyrtim me pretendimin se kërkesat tona që ndërlidhen me referencat për ndërtime të larta janë kufizuese dhe se duhet te pranohen edhe referencat për ndërtime të ulta dhe ne në përgjegjen tonë ndaj të njejtit kemi sqaruar në detaje pse janë vendosur ato kritere.Pas pergjigjes tone asnjë OE-ik i interesuar për këtë aktivitet nuk e ka kontestuar kerkesen tone dhe kemi konstatuar se kërkesat tona janë të pranueshme për të gjithë të interesuarit e posaçërisht për OE-ik si ju që kanë marrë pjesë duke dorëzuar ofertat e tyre.Pra është e qartë se referencat e dorëzuara nga ju kryesisht janë referenca të ndërtimit të ulët dhe si të tilla nuk janë në harmoni me kërkesat e FDT-së;

-Pretendimi se gabimi në paramasë(përseritja e një pozicioni) kamund të sqarohet është i bazuar,por ky sqarim nuk është kërkuar pasi qe nuk keni plotësuar kërkesat tona lidhur me referencat e kërkuara;


-Pretendimet tuaja lidhur me referencat e grupit të OE-ik të rekomanduar për dhënje të kontratës ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar dhe ka pranuar sqarimet lidhur me këtë dhe në materialin e kërkuar për çasje i keni pranuar edhe ju të njejtat.Dua vetëm t'ua përkujtoj se ne kemi konstatuar se kontrata e cekur me Mabco Construction ka qenë kontratë e rregulltë pasi që ka rezultuar se nuk e ka bazën kontraktuese në Institucionet publike si që pretendoni ju dhe si që e kemi menduar edhe ne,por është kontratë e bazuar në një donacion të huaj për fondacionin "Jahjaga",repektivisht donatori është HH Sheikha Fatima Bint Mubarak dhe në bazë të kësaj pjesa prej 6.649,980.28 euro është kontraktuar në mes të Mabco Construction dhe Fidola SHPK dhe për këtë janë dorëzuar dëshmitë e realizimit të kontratës dhe dëshmitë e pagesave nga bankat.Bazuar në këtë është pranuar kjo referencë e këtij tenderuesi,pasi qe eshte konstatuar se pranimi perfundimtar eshte bere me 31.12.2019 dhe per kete jane kerkuar dhe jane pranuar edhe deshmitet e pagesave te vertetuara nga Banka;

-Pretendimet lidhur me certifikatat nuk janë të bazuara,pasi që dokumentet origjinale që i kemi pranuar jo vetëm që janë të barasvlershme me kopjet e noterizuara,por edhe më të pranueshme se të njejtat.Poashtu ju sqarojmë se me formularin B 54-Njoftimin mbi korigjimin e gabimeve jeni njoftuar se nuk duhet dorëzuar gjashtë certifikata sipas kërkesave nga njoftimi për kontratë,por katër certifikata,të cilat edhe i ka dorëzuar tenderuesi i rekomanduar për dhënje të kontratës dhe bazuar në këtë ato certifikata është trajtuar i pranueshëm.

Bazuar në faktin se keni pretendime të pabazuara kerkesa juaj eshte refuzuar si qe eshte cekur edhe në dispozitiv të këtij Vendimit.

Këshillë juridike:Pala e pakënaqur me Vendimin mund të parashtoj ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit në afat prej dhjetë(10)ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Udhëheqësi i Prokurimit


(Zekë Bardhaj)